

## **Përmbledhja joteknike**

### **F & M Reklama Sh.p.k**

PËR AKTIVITETIN: Prodhimin e të gjitha llojeve të tabelave ndricuese dhe jo ndricuese, tabela me alukobond, punime plexiglassi, germa 3D, reklama në seri, reklama elektronike, printime

**Nentor / 2021**

**Tiranë, Shqipëria**

## Pasqyra e lëndës:

1.	HYRJE6	
1.1.	Kuadri ligjor.....	6
1.2.	Kuadri ligjor per vlerësimin e ndikimit në mjedis .....	6
1.1.	Baza ligjore e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.....	7
1.2.	Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve.....	9
1.3.	Legjislacioni për ujërat.....	9
1.4.	Vendodhja e aktivitetit.....	10
2.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT .....	11
3.	PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISUESES TE MJEDISIT.....	11
3.1.	Përshkrim i mbulesës bimore të sipërfaqes së zonës në vlerësim.....	11
3.2.	Fauna	12
3.3.	Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet Kulturore .....	12
3.4.	Demografia .....	12
3.5.	Klima	13
3.5.1.	Rreshjet .....	13
3.5.2.	Temperatura e ajrit .....	13
3.5.3.	Diellzimi .....	14
3.5.4.	Era .....	14
4.	IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS .....	15
4.1.	Metodologjia .....	15
4.2.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN .....	16
4.2.1.	Ndikimet e pritshme ne mjedis .....	16
4.2.2.	Ndikimet e mundshme negative ne uje .....	16
4.2.3.	Ndikimet e mundshme negative ne ajer .....	17
4.2.4.	Emetimet e zhurmave dhe gazeve te kamioneve ne mjedis .....	17
4.3.	Informacion për shkarkimet ne mjedis.....	18
4.4.	Informacion per vajrat.....	18
4.5.	Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative. ....	18
4.6.	Shtirirja hapesinore e ndikimit negativ ne mjedisin e zones.....	18
5.	Rehabilitimi i mjedisit te ndikuar dhe mundesia e kthimit te tij ne gjendjen e meparshme.....	19
6.	Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis .....	19
7.	Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille) .....	19
8.	PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT .....	19

## SHKURTESAT

VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
Shpk	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
mw	megawat
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi European
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
km	Kilometra
Sh.a	Shoqeri aksionere

# 1. HYRJE

**SUBJEKTI: "F & M Reklama" Sh.p.k**

**NIPT L31716006E**

**VENDNDODHJA: Tirane Vaqarr PRUSH Njesia Administrative Vaqarr, Rruga "Prush", Zona Kadastrale 3064, Pasuria Nr.151/57**

Subjekti ka qene i pajisur me leje te tipit C (Nr. 403, Lc-0079-07-2019) , sipas ligjit 10 448, date 14.07.2011 Per lejet e Mjedisit i ndryshuar sipas shtojces I,

- Pika 7.12 Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve.
  - a. Procesi i tharjes se shpejte te bojes se stampimit/printimit me ane te ajrit te nxehte. Konsumi i solventeve eshte i barabarte me 15 ton ne vit ose me pak se kaq.

Subjekti mbas kontrollit te bere nga Inspektoriati i Mjedisit eshte gjykuar qe subjekti ti nenshtrohet nje tjetere kategorie sipas ligjit 10 448, date 14.07.2011 Per lejet e Mjedisit i ndryshuar sipas shtojces I, veprimtaria tetjera qe perfshijne perdorimin e solventeve, ku perfshin lejen e tipit B.

Shoqeria **"F & M Reklama" Sh.p.k** me NIPT **L31716006E**, administrator Faolit Pahija, eshte nje subjekt i regjistruar ne QKB dhe zhvillon aktivitetin e tij ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushene reklamave. Qellimi i ketij subjekti ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe perndiqet dhe zbatohet me rigorozitet menaxhimi i cilesise ne te gjitha hallkat e saj. Subjekti kasiguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti. Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi zona nuk ka objekte apo vepra hidroenergjetike dhe nuk shkaktohet shqetesim per zonat e banuara te ndodhura prane vendit te ushtrimit te veprimtarise setij.

## 1.1. Kuadri ligjor

### 1.1.1. *Kuadri ligjor per vleresimin e ndikimit ne mjedis*

Shqipëria ka një legjislacion specifik i cili kërkon kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Ligji i vitit 2002 për Mbrojtjen e Mjedisit ka përcaktuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë dhe kërkesën për kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe marrjen e lejes mjedisore përpara se të fillojë një projekt. Ai përcakton kërkesat monitoruese për identifikimin e ndikimit që do të ketë një projekt gjatë fazave të ndërtimit, operimit dhe rehabilitimit, si dhe kërkesat gjatë fazës së mbylljes së projektit. Ligji u zëvendësua me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, i cili synon të pasqyrojë direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikën më të mirë në lidhje me menaxhimin e mjedisit. Ligji i vitit 2011 për Mbrojtjen e Mjedisit (i ndryshuar) përcakton kuadrin ligjor të mbrojtjes së mjedisit, rregulloret dhe kompetencat institucionale, parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe lejet mjedisore. Ai përcakton aktivitetet që ndikojnë në mjedis, si: "çdo aktivitet ekonomik dhe social që përdor mjedisin ose një pjesë të tij, ose që shkarkon materiale dhe energji duke i ndryshuar karakteristikat e tij".

Kuadri ligjor për procedurën e VNM-së në Shqipëri bazohet në Ligjin Nr. 10440 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", miratuar më 07.07.2011 dhe më pas me Ligjin Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 07.07.2011, Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis "dhe VKM-në nr. 10 448, datë 14.07.2011" Për Lejet Mjedisore", i ndryshuar. Një kuadër i rëndësishëm ligjor për VNM-në është gjithashtu VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar, dhe VKM nr. 247, data 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

## 1.2. Baza ligjore e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Kuadri ligjor për procedurën në Shqipëri për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)<sup>1</sup> bazohet në Ligjin Nr. 10440 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", miratuar më 07.07, 2011 dhe më vonë i ndryshuar me Ligjin

Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011, Për Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis" dhe VKM Nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet Mjedisore" të ndryshuar. Kuadri kryesor ligjor për procedurën e VNM përfshin gjithashtu VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për rregullat, përgjegjësitë, afatet kohore për procedurën e VNM dhe procedurën e transferimit të vendimit për deklaratën mjedisore" të ndryshuar, dhe VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informacionin publik dhe përfshirjen në procesin e vendimmarrjes në mjedis".

Kjo VNM shqyrton kërkesat e kuadrit rregullator, politikave dhe udhëzimeve të Qeverisë Shqiptare. Këto Ligje dhe Vendime (VKM) janë renditur më poshtë dhe konsiderohen të rëndësishme për përcaktimin e përmbajtjeve të hollësishme të kësaj VNM-je dhe qasjen në vlerësimin e ndikimit:

- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 52/2020 për disa ndryshime të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet Mjedisore" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit";
- Ligji Nr. 146/2014, datë 30.10.2014 "Për Informimin dhe Konsultimin Publik";
- Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit";
- Ligji 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis";
- Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" i ndryshuar;
- Ligji 111/2012, datë 15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018 "Për disa ndryshime dhe azhurnime" Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore";
- Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës";
- Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 81/2017, datë 04.05.2017 "Për Zonat e Mbrojtura";
- Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për Mbrojtjen e Faunës së Egër";
- Ligji Nr. 10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë";
- Ligji Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeumet";
- VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësitë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore" të ndryshuar;
- VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informacionin publik dhe përfshirjen në procesin e vendimmarrjes në mjedis";
- VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja";
  - VKM Nr. 994, datë 02.07.2008 "Për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore";
  - VKM Nr. 912, datë 11.11.2015 "Për miratimin e Metodologjisë Kombëtare të Procesit VNMS";
  - VKM Nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit";
  - VKM Nr. 803, datë 04.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit";

---

<sup>1</sup>Legjislacioni shqiptar i referohet VNM dhe jo VNMS. Nëse bëhen referenca për procedurën shqiptare do të përdoret shkurtesa VNM. Nëse bëhen referenca për qasjen më të gjerë të projektit, akronimi VNMS do të përdoret.

- VKM Nr. 248, datë 24.04.2003 "Për miratimin e normave të përkohshme për emetimet në ajërdhe zbatimin e tyre";
- VKM Nr. 352, datë 29.4.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe kërkesat përdisa ndotës të lidhur me to";
- VKM Nr. 4802 datë 31.07.2018 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë përperiudhën 2018-2030".
- VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionin që duhet të përfshihet në shënimin e transferimit";
- VKM Nr. 371, datë 11.06.2014 "për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme";
- VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 "Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim";
- VKM Nr. 652, datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomate përdorura";
- VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- VKM Nr. 99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve" i ndryshuar;
- VKM Nr. 866, datë 04.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";
- VKM Nr.177, datë 06.03.2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 06.3.2012, të këshillit të ministrave, për ambalazhet dhe mbetjet e tyre";
- VKM Nr. 705, datë 10.10.2012 "Për automjetet e dala jashtë përdorimit";
- VKM Nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";
- VKM Nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore";
- VKM Nr. 267, datë 07.05.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore";
- VKM nr. 177, datë 31.03.2005 " Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"; amenduar nga vendim i KM 232 26.04.2018 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 06.3.2012.
- VKM Nr. 742, datë 09.09.2015 "Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e të transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe të ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe të formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve nga operatori".
- VKM Nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit".
- VKM Nr. 587, datë 07.07.2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"; i ndryshuar.
- VKM Nr. 866, datë 10.12.2014 "Për miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për bashkimin evropian";
- VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 "Për Shpalljen e Zonave të Mbrojtura dhe Monumenteve Natyrore të Shqipërisë";
- VKM Nr. 31, datë 20.01.2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
- Udhëzimi Ministror Nr. 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara";
- Udhëzimi Nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit";
- Udhëzimi Ministror Nr. 4, datë 12.09.2008 " Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor";
- Udhëzimi Ministror Nr. 6527, datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre."

### 1.3. Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve

Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri ka përparuar me miratimin e ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve të reja. Qëllimet dhe afatet e parashikuara nga ligjet dhe strategjitë kombëtare janë në përputhje me kërkesat e BE. Një nga objektivat e rëndësishme të kuadrit ligjor dhe arsyeja kryesore e kësaj qasje nga lart-poshtë është krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorët ndërkombëtarë (në fonde të veçanta të BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme.

Ligji ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta. Për këtë qëllim, ai përcakton rregulla për trajtimin mjedisor të mbetjeve të ngurta në çdo fazë: krijimit, grumbullimit, ndarjes, transportit, riciklimit, përpunimit dhe deponimit. Ligji më tej ka për qëllim reduktimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimit të mbetjeve toksike dhe të rrezikshme. Ligji zbatohet nga:

- VKM Nr. 389, datë 27.6.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave "Për Landfilllet e Mbetjeve"
- VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"
- VKM Nr. 94, datë 14.2.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte"
- VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- VKM Nr. 641, datë 1.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte"
- VKM Nr. 117, datë 13.2.2013 "Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qenuri mbetje".
- VKM Nr. 177, datë 6 mars 2012 "Për paketimin dhe paketimin e mbetjeve".
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Mbi miratimin e listës shqiptare për klasifikimin e mbetjeve".
- Urdhër Nr. 893, datë 4.10.2013 "Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vavra të përdorura".

Amenduar nga:

- Ligj nr. 32/2013 datë 14.2.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Ligj nr. 156/2013 datë 10.10.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar"
- Këto udhëzime nënvijëzojnë nevojën për zbatimin e një hierarkie të menaxhimit të mbetjeve që përfshin parandalimin, riciklimin/ ripërdorimin; trajtimin dhe asgjësimin. Udhëzimet kërkojnë ndarjen e mbeturinave konvencionale nga mbetjeve të rrezikshme dhe në qoftë se gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme nuk mund të parandalohet (siç është rasti në objektet e kujdesit shëndetësor); menaxhimi i tij duhet të fokusohet në parandalimin e dëmit ndaj shëndetit, sigurisë dhe mjedisit, në përputhje me parimet e mëposhtme:
- Njohja dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme dhe rreziqeve që lidhen me menaxhimin e çdo lloji mbetje të rrezikshme të krijuar gjatë ciklit jetësor të saj të plotë.
- Sigurimi që njerëzit/firmat që merren me trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme janë ndërmarrje me reputacion dhe legjitime, të licencuara nga agjencitë përkatëse rregullatore dhe këto zbatojnë praktikën me të mira të industrisë.
- Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret e aplikueshme.

### 1.4. Legjislacioni për ujërat

Legjislacioni Shqiptar për ujërat është përafëruar plotësisht me: Direktivën 2000/60/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 23 Tetor 2000, "Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave". Numri CELEX: 32000L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 327, datë 22.12.2000, faqe 1-73

Ligji Nr. 111/2012, date 15.12.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" ka si qëllim: a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujqor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkuftare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit të efektshëm të tyre; ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; dhe d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të njëjve politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

Disa nene të këtij ligji janë amenduar me ligjin Nr. 6/2018 date 08.02.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar. Kompetencat, procedurat dhe standardet nën të cilat ERRU operon burojnë nga ky ligj: si ligji Nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura".

Një sërë ligjesh të tjera të Republikës së Shqipërisë kanë ndikim në ushtrimin e funksioneve të ERRU siç është ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, ligji për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike, etj.

Vendimet e Këshillit të Ministrave janë aktet nënligjore që plotësojnë kuadrin ligjor të sektorit ujësjellës-kanalizime në Shqipëri.

- VKM nr. 643, datë 14.09.2011 "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve"
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për Miratimin e Modelit të Rregullores për Furnizimin me Ujë dhe për Kanalizimet në Zonën e Shërbimit të Ujësjetës Kanalizimeve sha."



## 2. Vendodhja e aktivitetit

Vendi i ushtrimit te aktivitetit ndodhet ne Rruga Prush, Vaqarr Tiranë. Ky aktivitet ka per qellim printime, stampime me bojra, perdorimin e solventeve.




Figura 1. Vendodhja e aktivitetit

## 3. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Qellimi i aktivitetit:

Prodhimin e te gjitha llojeve te tabelave ndricuese dhe jo ndricuese, tabela me alukobond, punime plexiglasi, germa 3D, reklama ne seri, reklama elektronike, printime dhe brandim fasadash te brendshme dhe te jashtme, brandim automjetesh, skenografi, stenda dhe artikuj promocioni, tabela sinjalistike, etj. Importin e te gjitha lendeve te para, materialeve dhe pajisjeve per realizimin e produkteve te mesiperme, tregetin e tyre brenda vendit, si edhe eksportin e tyre ne vendet e tjera. Importin dhe prodhimin e artikujve te ndryshem promocionale, si stilolapsa, cakmak, bluza, kapele, dhe artikuj te tjere te kesaj natyre, si edhe tregetin e tyre brenda dhe jashte vendit. Importin e e ndricuesave te ndryshem, Led ose jo Led, dhe tregetin e tyre brenda dhe jashte vendit. Sherbime te ndryshme marketingu, si webdizajn, reklama televizive dhe radiofonike, printime te ndryshme, si kartivita, fletepalosje, banera, organizim aktivite te ndryshme promocionale, etj. Projektme dhe zbatime te ndryshme

Adresa e aktivitetit: Tirane Vaqarr PRUSH Njesia Administrative Vaqarr, Rruga "Prush", Zona Kadastrale 3064, Pasuria Nr.151/57

Lendet e para qe perdoren jane si me poshte:

- solvente
- letra, tabake kartoni
- bazat e bojrave qe merren te gatshme.
- Pexiglass



Figura 2. Ploteri i madh per stampime



Figura 3. Freza prerese



Figura 4. Serigrafji



Figura 5. Ploteri Printer

## 4. PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISUESES TE MJEDISIT

### 4.1. Përshkrim i mbulesës bimore të sipërfaqes së zonës në vlerësim

Vendi ku do të zhvillohet aktiviteti për printime dhe stampime është një zonë e zhveshur nga bimesia. Zona përreth nuk ka ndonjë densitet të konsiderueshëm ndërkohëse përveçse disa shtepi në distancë të konsiderueshëm nga objekti në studim dhe të aktivitetëve në rrugën nacionale Tiranë-Durrës ecila dhe ato ndodhen në një distancë të largët nga njëra –tjetra. Terreni është relativisht i sheshtë dhe zonapërreth është e sheshtë, e cila dominohet nga toka bujqësore të pazhrytezuara. Zona kryesisht përdoret për bujqësi dhe industri.

### 4.2. Fauna

Në koridore më pak të trazuar nga njëri e në periferi nga ana veriore mund të takohet rrallë lepuri i egër (*Lepus europaeus*), *Plecotus auritus* (lakuriqi veshgjatë) *Nyctalus noctula* (lakuriqi i natës) ndërsa brejtësit janë me evident afër ndertimeve rezidenciale e veçanërisht në kanalizimet. Në avifaunën e rajonit në shqyrtim bëjnë pjesë shpendë të mjedisit urban si dhe ato karakteristike të shkurretave si *Anthus campestris*, *Corone cornix*, *Corvus corax*, *Pica pica*, *Passer domesticus*, *Carduelis carduelis*, etj. Takohen gjithashtu gargulli i zi (*Sturnix vulgaris*), lauresha (*Aleuda arvensis*), mellenja (*Turdus merula*), trishtilat, harabelat, gushkuqet etj. Veçanërisht në tërrene më të thata, reptilet janë më të pranishëm si *Lacerta viridis*, *Lacerta trilineata* (hardhucë e gjelbër me tre vija), *Podarcis muralis*, *Anguis fragilis*, *Natrix tessellata* (gjarpër) e breshka e zakonshme (*Testudo hermani*). Prania e lumit të Tiranës nënën jug-perëndimore të zonës në studim ka favorizuar veçanërisht në dy anët e tij si dhe në kanalet kulluese praninë e amfibëve si bretkosen e zakonshme (*Rana ridibunda* Pall), thithlopën e zakonshme (*Bufo bufo*), thithlopën e gjelbërt (*Bufo viridis* Laur).


### 4.3. Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet Kulturore

Zona ku ndodhet aktiviteti nuk është zonë e mbrojtur sipas kriterve të IUCN-së apo sipas legjislacionit shqiptar për zonat e mbrojtura e biodiversitetin. Potencialet faunistike e floristike nuk janë përdorur në mënyrë të planifikuar ose për qëllime të veçanta nga subjekte të ndryshme qoftë dhe për bimë mjeksore në territorin ku planifikohet të bëhet rikualifikimi urban.

### 4.4. Demografia

Në 1 Janar 2020, Tirana zë rreth 31,8 % të popullsisë gjithsej, duke vazhduar të jetë një nga qarqet më të populluara të vendit. Përlllogaritjet e popullsisë në 1 Janar 2020 treguan se vetëm dy qarqe të vendit shënuan rritje të popullsisë, krahasuar me një vit më parë, ndërsa dhjetë qarqet e tjera shënuan rënie të popullsisë. Rritja më e madhe u shënuar në Tiranë (+1,2 %), pasuar nga Durrësi (+0,2 %).

Qarku/Pr efecture s	2016			2017			2018			2019			2020		
	Bur ra	Gra	Gjit hse j	Bur ra	Gra	Gjit hse j	Bur ra	Gra	Gjit hse j	Bur ra	Gra	Gjit hse j	Bur ra	Gra	Gjit hse j
Tiranë	419 ,35 1	423 ,63 0	842 ,98 1	427 ,91 5	434 ,44 6	862 ,36 1	436 ,91 7	447 ,07 9	883 ,99 6	442, 011	453 ,14 9	895 ,16 0	447, 525	458 ,64 1	906 ,16 6



## 4.5. Klima

### 4.5.1. Rreshjet

Për shkak të veprimtarisë së gjërë ciklonare sasia më e madhe e reshjeve vihen re në gjysmën e ftohtë të vitit, dhe ajo më e ulet në periudhën e ngrohtë të tij. Zona në studim është një nga zonat që karakterizohet nga sasi reshjesh vjetore të ulta mesatarisht 931 mm ne vit të cilat bien kryesisht në formë shiu.

Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor (132.9 mm), i ndjekur nga muaji dhjetor (113 mm). Muaji me më pak reshje është muaji korrik me 23.9 mm. Numri i ditëve me reshje  $\geq 1.0$  mm varion nga 2.4 ditë (korrik) deri në 11.1 ditë (dhjetor). Gjatë vitit ka mesatarisht 86.4 ditë me reshje  $\geq 1.0$ mm.

Zona në studim nuk klasifikohet si zonë me sasi të mëdha reshjesh 24-orëshe, ose më mirë ajo bën pjesë në zonat ku shirat janë më pak të rrëmbyeshëm. Megjithatë nuk përjashtohen edhe rastet kur sasia maksimale 24-oreshe ka arritur 180.8mm dhe 182.5mm përkatësisht në muajt nëntor dhe tetor. Ndërsa maksimumi 24 h për periudhën 30 vjeçare varion nga 43.0 mm në korrik (për vlerën me te ulet) deri ne 182.5 mm ne tetor te vitit 1962.

Rreshjet janë një element i rëndësishëm meteorologjik, që në rajonin e Tiranës kryesisht përfaqësohen nga shiu. Në tabelën më poshtë paraqitet sasia e rreshjeve sipas muajve dhe numuri i ditëve me rreshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjeçare meteorologjike.

Tabela 1. Sasia e reshjeve mujore dhe numri i ditëve me reshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjeçare meteorologjike

Muajt		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Vjetor
Reshjet														
Reshjet mujore mm		112	98	86	60	57	28	12	20	35	131	164	150	983
Max 24 orësh mm		89	83.6	63	66.1	67	77	35	65.3	72.3	182.5	180.8	59	1042.6
Numri i diteve me reshje	0.1 mm	13.3	11.5	10.7	8.8	7.5	4.9	3.5	3.5	5.7	10.7	12.4	14.4	106.9
	5 mm	6.1	5.5	5.1	3.5	3.3	1.8	1.0	1.5	2.5	5.4	8.5	7.2	51.4
	10 mm	4.2	3.3	2.7	1.9	1.9	0.9	0.5	0.9	1.6	3.6	5.5	4.1	31.1

#### 4.5.2. Temperatura e ajrit

Në rajonin e Tiranës, temperatura është më e lartë në muajt e verës (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjisë diellore është më e madhe, ndërsa temperatura më e ulët është në dimër, në muajin Shkurt. Përsa i përket veçorive sezonale mund të themi se gjysma e ngrohtë Prill-Shtator karakterizohet nga një temperaturë mesatare prej 20,6°C ndërsa gjysma e ftohtë është 12,4°C. Performanca vjetore e temperaturave absolute maksimale të ajrit është e njëjtë me atë të temperaturave mesatare, dmth me një minimum në janar dhe një maksimum në korrik ose gusht. Temperaturat maksimale absolute > 30 ° C fillojnë të regjistrohen nga maji dhe vazhdojnë deri në shtator. Temperatura maksimale më e lartë absolute e vërejtur është 38.6°C në korrik (viti 1988). Një nga treguesit më të rëndësishëm për të karakterizuar temperaturat maksimale të ajrit është mesatarja maksimale, vlerat e së cilës variojnë nga 12 ° C në janar deri në 27.8 ° C në korrik. Në këtë zonë janë vërejtur vlera jo shumë të ulëta të temperaturës minimale absolute. Shfaqja e vlerave negative të këtij treguesi nuk është një ngjarje e rrallë. Këto vlera sigurisht që janë të pranishme në gjysmën e ftohtë të vitit. Minimumi i tyre absolut arrihet në janar (-6.0 ° C). Por duhet përmendur gjithashtu se vlera të ulëta të këtij treguesi janë vërejtur që nga nëntori (-1.6 ° C) deri në mars (-5.2 ° C). Kjo zonë, si në rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga një numër i madh orësh me diell. Mesatarisht gjatë vitit ka 2655 orë me diell, me vlerën më të lartë në korrik me 355 orë dhe më të ultën në dhjetor me 107 orë.

**Tabela 2. Temperatura gjatë gjithë vitit në Durrës dhe Tiranë**

Mujore	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	
Temperatura													
Mesatare °C	7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0	
Mesatarja mujore	Me e larta	-11.6	11.7	14.2	16.6	20.7	23.8	26.2	25.8	24.0	20.2	15.8	12.1
	Me e ulta	4.1	5.4	7.8	11.9	16.7	19.4	22.7	21.0	19.6	15.2	11.9	6.4
Max.absolute	18.8	22.1	24.9	28.6	31.3	35.0	37.7	39.0	34.0	32.2	26.0	21.7	
Min.absolute	-7.4	-4.6	-3.0	2.4	6.2	11.0	13.6	11.0	8.2	5.0	2.0	-7.2	

#### 4.5.3. Diellezimi

Rajoni diellezim të lartë. Vlera e rrezatimit vjetor varjojnë nga 2600 në 2700 orë. Numri i ditëve me diell varion nga 320-330 ditë.

Rrezatimi diellor ndjek pothuajse të njëjtën shpërndarje vjetore ndër vite. Energjia mesatare diellore gjatë një viti është 1600 kW orë, vlerat më të larta janë vërejtur në korrik 223.5 kW orë dhe më e ulta në dhjetor 52.9 kW/orë. Në tabelën vijuese jepen shpërndarjet mesatare mujore shumëvjeçare të diellezimit dhe rrezatimit diellor.

**Tabela 3. Diellezimi (orë) dhe rrezatimi diellor (kW h/m<sup>2</sup>)**

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17.3	17.6	13.5	9.6	6.1	6.1	105.9

**Tabela 4. Vlera mesatare e diteve me re**

Stacioni monitorimit	i	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana		12.3	12.6	12.2	11.7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7

**Tabela 5. Vlera mesatare e rrezatimit**

Stacioni monitorimit	i	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana		142.9	208.3	300	358.1	476.8	549.1	570	511	398.7	270	172.5	135.6	4093

#### 4.5.4. Era

Të dhënat për shpejtësinë e erës për rajonin janë:


30 m/sek: një herë në çdo 10 vjet

33 m/sek: një herë në çdo 20 vjet

38 m/sek: një herë në çdo 50 vjet.

**Tabela 6. Intesiteti i erës sipas drejtimeve**

Nr	Elemente	N° era	Drejtimi							
			V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
1.	Shpërndarja vjetore e drejtimit në %	11.9	27.5	2.9	4.3	16.7	8.2	4.7	12.5	8.1
2.	Shpejtësia mesatare, m/s	-	3.3	2.4	3.5	4.5	6.7	5.8	4.9	4.4



**Figure 1. Trendafili i erës**

Siç mund të shihet, periudhat pa erë përfaqësojnë 11.9% të rasteve totale të drejtimit të erës. Duke iu referuar tabelës dhe trëndafilut të erës vërejmë se drejtimi verior është mbizotërues me 27.5%, ndërsa

vlerat minimale të rasteve janë sipas drejtimit verilindor me 2.9%. Shpejtësitë mesatare sipas këtyre drejtimeve janë: 3.3 dhe 2.4 m / s përkatësisht.

**Tabela 7. Mesatarja e shpejtësisë së erës sipas stinëve**

Nr.	Stinët	Shpejtësia m/s
1	Dimri (XII-I)	4.9
2	Pranvera (III-V)	4.4
3	Vera (VI-VIII)	3.9
4	Vjeshta (IX-XII)	4.3
5	Vjetore (I-XII)	4.4

Referuar tabelës së mësipërme, shpejtësia mesatare në sezonin e dimrit është 4.9 m / s, ndërsa mesatarja vjetore është 4.4 m / s. Erërat e forta që fryjnë në veri, juglindje me shpejtësi 40-45 m / s zakonisht kanë një kohëzgjatje të kufizuar. Erërat me shpejtësi 10-20 m / s jo vetëm që kanë një shans më të madh por edhe kanë drejtim më të qëndrueshëm.

## 5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

### 5.1. Metodologjia

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një aktiviteti të propozuar është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhet identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarisë, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin enjeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Ky aktivitet parashikohet të ketë ndikim negative gjatë fazës së ndërtimit ndërsa gjatë fazës së operimit nuk parashikohen ndikime negative.

### 5.2. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshte.

#### 5.2.1. Ndikimet e pritshme ne mjedis

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

#### **Ndikimet e mundshme negative ne toke**

Tabela 8. Ndikimet e mundshme negative ne toke

Lloji i Ndikimit	Ndikimi i Mundshem
------------------	--------------------

<b>Funksionimi i aktivitetit gjate printimeve stampimeve, prerjeve te pexiglass-it.</b>	Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme aksidentale te bojës, solventeve gjate procesit te
<b>Levizja e automjeteve te shumta te cilat vijnene siperfaqen e aktivitetit per te marre sherbimin e kerkuar</b>	Si pasoje e levizjes se makinave: <ul style="list-style-type: none"> <li>do te kemi ngjeshje te tokes ne sektore te vecante te saj,</li> <li>mund te kemi rrjedhje aksidentale te lubrifikanteve nga ndonje avari me pasoje ndotjete tokes.</li> </ul>
<b>Parkim i automjeteve (te cilat vijne ne keteaktivitet per te marre sherbimin e kerkuar).</b>	Si rezultat i pershtatjes se siperfaqeve te caktuaraper parkimin e mjeteve te punes dhe magazinimine lendeve te para, mund te ndodhe ngjeshje e tokes.

### 5.2.2. Ndikimet e mundshme negative ne uje

Tabela 9. Ndikimet e mundshme negative ne uje

Lloji i Ndikimit	Ndikimi i Mundshem
<b>Funksionimi i aktivitetit per lyerjen dhe lustrimin e makinave.</b>	Shkarkimet ne ujera vijne nga: <ol style="list-style-type: none"> <li>Ujerat e perdorur per ambjentethigjenosanitare te ambjentit te stafit.</li> <li>Ujerat e lagies se sheshit te aktivitetit, ne pjesen e jashtme te tij.</li> <li>Ne rastet e pastrimit te automjeteve para procesit te lyerjes.</li> <li>Pastrim i ambjentit ne rast derdhjes se bojës gjate procesit te lyerjes.</li> </ol>
<b>Levizja e automjeteve te transportit dhe perdorimi i makinave ne procesin e lyerjes dhe lustrimit te makinave.</b>	Si pasoje e qarkullimit te mjeteve dhe perdorimit te mekanikes mund te kemi rrjedhje aksidentale te lubrifikanteve nga ndonje avari e mundshme me pasoje ndotje te ujerave siperfaqesore dhe nentokesore.
<b>gazinim i lendeve te para dhe parkim i automjeteve.</b>	Rrjedhje vajrash dhe lubrifikantesh nga automjetet e parkuar, depozitim i mbetjeve nga materialet ne trupat ujore te zones.

### 5.2.3. Ndikimet e mundshme negative ne ajer

Tabela 10. Ndikimet e mundshme negativene ajer

j i ndikimit	ikimi i Mundshem
<b>Funksionimi i aktivitetit te lyerjes dhe lustrimit te makinave.</b>	Gjate procesit te lyerjes se makinave ne furre me avull te nxehte. Avulli qe del nga furra gjate procesit te lyerjes kalon ne aspiratore i cili eshte i pajisur me filtra dhe me pas dalja jashte ne atmosfere.
<b>Levizja e automjeteve te transportit dhe perdorimi i makinerive ne subjekt.</b>	Si pasoje e levizjes se automjeteve do te gjenerohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>zhurma,</li> <li>pluhur,</li> <li>gaze nga djegia e karburantit te motoreve.</li> </ul>



#### 5.2.4. Emetimet e zhurmave dhe gazeve te kamioneve ne mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjate fazes se funksionimit, duhet theksuar se ky ndikim eshte i perkohshem. Zhurmat do jene per sa subjekti do te jete ne funksionim. Subjekti zbaton me rigorizitet qe mos te punohet gjate oreve te nates.

Nderkohe, Udhezimi nr.8 date 27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara", percakton vlerat e lejuara te zhurmes si ne tabelen e meposhtme.

Tabela 11. Nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara

Mjedisi	Efekti kritik ne shendet	Laeq (dBA)	Koha baze (ore)	LAmaz Fast (dB)
Zona banimi				
Jashte banese	<b>Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes</b>	<b>55</b>	<b>16</b>	
Ne brendesi te banesave	<b>Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes</b>	<b>35</b>	<b>16</b>	
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	<b>Prishja e gjumit naten</b>	<b>30</b>	<b>8</b>	
Jashte dhomes se fjetjes	<b>Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashte)</b>	<b>45</b>	<b>8</b>	
Zonat me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi i trafiku (mjedis i jashtem i brendshem)	<b>Dentimi, degjimi</b>	<b>85</b>	<b>1</b>	<b>110</b>

Shpjegime:

- LAeq (dBA)= Niveli ekuivalent i matur ne shkallen A
- Koha baze (ore)= Koha gjate se ciles behet matja
- LAmaz Fast (dB)= Niveli i matur ne shkallen A ne menyren Fast (e shpejte)
- # 1= Sa me e ulet qe te jete e mundur
- # 2= Presioni zanor maksimal (LAmaz, fast) matur 100 mm larg veshit
- # 3= Zonat e jashtme te qeta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur
- # 4= Nen kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat e fushes se lire

Nga krahasimi i nivelit te zhurmave qe lirojne mjetet e punes me ato kufi te lejuara verehet se nivelet e lejuara te zhurmave ne qendrat e banuara me te aferta gjate kohes se zbatimit te projektit nuk tejkalohen.

#### 5.3. Informacion për shkarkimet ne mjedis

Shkarkimet ne mjedis gjate funksionimit te aktivitetit per Lyerjen dhe Lustrimin e makinave do te jete kryesisht avujt te cilet dalin nga aspiratori, i cili eshte i lidhur me furren ku lyhen makinat. Ne kete aspirator jane te vendosur disa filtra per te permiresuar cilesine e avujve qe do te dalin ne atmosfere.

Identifikimi i burimeve ujore ne afersi te aktivitetit

Ne afersi te aktivitetit nuk identifikohen burime ujore. Nga inspektimi ne vendin ku ndodhet aktiviteti eshte

vene re qe ndodhet afer rezervuarit te Kasharit.

Subjekti ujin te cilin i nevojitet per funksionimin e aktivitetit e siguron nga pusi.

#### **5.4. Informacion per vajrat.**

Subjekti ka lidhur kontrata me firma nenkontraktuese per grumbullimin dhe depozitimin e vajrave.

#### **5.5. Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative.**

Ndikimi i aktivitetit te servisit, te lyerjes lustrimit te makinave ne kushte normale do te zgjase per aq kohe sa zgjat aktiviteti.

#### **5.6. Shtrirja hapesine e ndikimit negativ ne mjedisin e zones.**

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mbetet vetem brenda ambientit te lyerjes dhe lustrimit te makinave. Nuk vleresohet aktivitet me ndikim me shtrirje hapesine, kjo per vete faktin se nuk ka shkarkime te demshme ne ajer, ne uje apo ne toke.

### **6. Rehabilitimi i mjedisit te ndikuar dhe mundesia e kthimit te tij ne gjendjen e meparshme.**

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt te sigurt dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per mjedisin. Mjedisi ku zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojte per rehabilitim. Nuk do te kete punime ne toke.

### **7. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.**

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit biologjik dhe fizik.

- mbetjet e ngurta (urbane) te menaxhohen ne menyre te integruar. Do te menaxhohen nga kompania per tu depozituar me pas ne pikat e bashkise.
- Bojerat merren te gatshme dhe nuk ka ndotje per aksidente te tilla ne toke.
- Ambienti ka kushte te larta higjenike.

### **8. Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje ne kushtet normale, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Ne kete kontekst nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

## 9. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

Programi i përmirësimit të subjektit Bushi ka gjithmonë në fokus monitorimin e vazhdueshëm të parametrave/elementëve mjedisore dhe rritjen e ndërgjegjësimit të stafit nëpërmjet trajnimeve për mjedisin dhe sigurinë në punë.

Rekomandimet për përmirësimin e programit të monitorimit dhe menaxhimit të mirë të mjedisit përfshijnë si më poshtë:

- Menaxhimin e rregullt të të gjithë mbetjeve të gjeneruara si pasojë e aktivitetit, përfshirë mbetjet e ngurta dhe mbetjet e lëngshme;
- Ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe ruajtjen e tyre në konteinerë apo kosha të posaçëm deri në momentin e largimit nga subjekti;
- Raportimin e rregullt të sasive të mbetjeve të gjeneruara dhe sasive të mbetjeve të depozituara/asgjësuar nëpërmjet raportit të vetmonitorimit;
- Menaxhimin e mbetjeve nëpërmjet nënkontraktorëve të licensuar, veçanërisht për mbetjet e rrezikshme (vaj i djegur) dhe mbetjet metalike (skrap);
- Magazinimin në kushte optimale të lëndëve të para dhe marrjen e masave paraprake për sigurimin në kushtet e emergjencës dhe shkarkimet e mundshme aksidentale;
- Mbajtjen pastër dhe sa më të sistemuar të materialeve në ambientin e punës;
- Shmangien e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore si rrjedhojë e aktiviteteve të projektit apo nënprodukteve/mbetjeve të tyre;
- Monitorimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë së ajrit dhe nivelit të zhurmave si në ambientet e brendshme të godinës ashtu edhe në ambientet e jashtme në afërsi të saj;
- Analizimin e cilësisë së ujërave nëntokësore në vendodhjen e pusit nga ku subjekti merr ujin për plotësimin e nevojave të tij;
- Analizimin e cilësisë së ujërave të ndotura/ujërave të zeza të shkarkimit.

Tabela 12. Programi i Përmirësimit Për Mbrojtjen e Mjedisit

Objektivi	Masat për përmirësimin e teknikave operacionale	Përmirësimi i pritur	Metoda e raportimit të rezultateve
Trajnime dhe informim i stafit nga drejtuesit e kompanisë.	<p>Informim i vazhdueshëm për mbrojtjen e mjedisit dhe teknikave të menaxhimit të mirë.</p> <p>Njohja e stafit me materialet e përdorura në punë dhe rrezikshmërinë e tyre në momentin e kthimit në mbetje.</p> <p>Njohje me teknikat e menaxhimit të mirë të mbetjeve.</p> <p>Periodike gjatë gjithë zhvillimit të veprimtarisë.</p>	<p>Rritje e kujdesit dhe përgjishmërisë së stafit gjatë punës.</p> <p>Ulje të mundësisë për aksidente në punë dhe ndotje të mjedisit.</p>	Raport me shkrim në të cilin do të paraqitet programi dhe objektivat e trajnimit, regjistrimi i personave të trajnuar.

<p>Punimet e sistemimit dhe mirëmbajtjes së aktivitetit.</p>	<p>Investime të mundshme gjatë gjithë periudhës së funksionimit të aktivitetit.</p>	<p>Ambient miqësor me mjedisin dhe veprimtarinë.</p> <p>Shmangie aksidenteve apo ngjarjeve të papalnfikuara nëpërmjet mirëmbajtjes dhe kontrollit të vazhdueshëm.</p>	<p>Raport periodik me shkrim (raporti i vetmonitorimit të mjedisit).</p>
<p>Zbatimi të gjitha kushteve që do të përcaktohen në lejen mjedisore të tipit B.</p>	<p>Gjatë gjithë periudhës së funksionimit të veprimtarisë.</p>	<p>Përputhshmëri me kërkesat dhe detyrimet ligjore shqiptare.</p> <p>Rritja e sigurisë për punonjësit dhe komunitetin përreth, si dhe përmirësimi i masave për mbrojtjen e mjedisit.</p>	<p>Raport periodik me shkrim (raporti i vetmonitorimit të mjedisit).</p>